

VENDIM
Nr.89, datë 6.8.2008

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13, si dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.8.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike (Bllok motorë –gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë),

Konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Albanian Green Energy” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.55, datë 29.5.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” nuk parashikon të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Oponenca tekniko-ekonomike është paraqitur pranë AKBN, e cila ende nuk është shprehur mbi këtë projekt.

4. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike (Bllok motorë–gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë) me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s oponencën tekniko-ekonomike nga ekspertë të licencuar brenda 60 ditëve nga lëshimi i licencës.

b) Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuar detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

c) Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

d) Koha e zbatimit të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj.

e) Mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta